Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës
Nr. 04-020/04-0360270/26 **dt.** 14.10.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, nenet 31 dhe 40, nenin 64 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe Kërkesa elektronike nga Zyra e Kryetarit, dt. 06.10.2026, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit për hartimin e Draft - Rregullores për Masat Teknike dhe Organizative për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Komunën e Mitrovicës së Jugut)

1. **FORMOHET** Komisioni për hartimin e Draft - Rregullores për Masat Teknike dhe Organizative për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Komunën e Mitrovicës së Jugut, në këtë përbërje:

   1.1 Bedri Muja– Kryesues (Zyra Ligjore);
   1.2 Valbone Peci – Anëtare (Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore);
   1.3 Sofije Rushiti Peci – Anëtare (Zyra për Komunikim me Publikun);
   1.4 Hanife Rushiti Hakaj – Anëtare (Drejtoria për Administratë të Përgjithshme);
   1.5 Artan Xhaka – Anëtar (IT- Drejtoria për Administratë të Përgjithshme).

2. Komisioni është përgjegjës që të bëj hartimin e Draft - Rregullores për Masat Teknike dhe Organizative për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Komunën e Mitrovicës së Jugut, duke bërë harmonizimin e saj me dispozitat ligjore pozitive në fuqi.

3. Komisioni në fjalë obligohet që pas hartimit të Draft - Rregullores së lartcekur të njëjtën ta procedojë në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim përmes Kryetarit të Komunës.

4. Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, dhe

sipas nevojës të konsultohet me Agjencinë për Informim dhe Privatësi (AIP), si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

5. Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi ka mandat deri në përfundimin e detyrave të përcaktuara me këtë vendim.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Faton PECI

Shtojcë:
1x1 Kërkesa Elektronike nga Zyra e Kryetarit, dt. 06.10.2026;
1x1 Kërkesa Elektronike nga z. Alban Fejzullahu, Drejtor i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme, dt. 06.10.2026.

T'i dërgohet:
1x1 Kryetarit të Komunës
1x1 Zyrës Ligjore
1x1 Zyrës për Informim
1x1 Anëtarëve të Komisionit
1x1 Arkivit